



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 665/1 Prot

Tiranë, me 21/07 / 2015

Lënda: Jepet mendim mbi Draft-Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

Drejtuar: **Z. Arian KRAJA**
Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes

Tiranë

Në përgjigje të shkresës Nr.5619/1, Prot. datë 06.07.2015, projekt/Rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” dhe Udhëzuesi “Politikat për Sigurinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Teknologjisë së Informacionit (PSNTI)” vlerësohen të hartuar konform kërkesave të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Ndërsa, sugjerojmë të shmangen në p/Rregullore, përsëritjet e panevojshme të termave, nocioneve apo përmbajtjet në tërësi të dispozitave, duke integruar dy ose më shumë prej tyre në një dispozitë të vetme (p.sh. neni 1 dhe neni 2 i p/rregullores mund të përfshihen në një dispozitë).

Në nenin 4 të këtij projekti, përkufizimet e parashikuara duhet të specifikohen konkretisht në bazë të veprimtarisë që ushtrohet nga institucioni juaj (p.sh. nëse ju transmetoni të dhëna në marrës të tjerë jashtë institucionit tuaj apo realizoni delegim të përpunimit të të dhënave në të tretë, parashikoni konkretisht përmbajtjet e përkufizimeve “marrës”, “transmetim”, “përpunimi i kontraktuar me të tretë”, etj).

Përgjegjësitë e parashikuara në nenin 8 të po këtij p/akti i përkasin personit të ngarkuar dhe për rrjedhojë titulli i kësaj dispozite duhet zëvendësuar me “personi i ngarkuar”.

Në nenin 13 të p/Rregullores, evidentohet se përpunohet “e dhëna mbi kombësinë”. Sugjerojmë fshirjen e këtij parashikimi, pasi ky është një përbërës që nuk përdoret më në shërbimin e gjendjes civile në përputhje me Vendimin nr. 52 datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese i cili ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën termin “kombësi”.

Përmbajtja e nenit 16/3 duhet të parashikohet në përputhje me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar (referojuni udhëzimit në faqen zyrtare www.idp.al).

Në përmbajtje të kësaj rregulloreje duhet të parashikohet një dispozitë mbi afatet e mbajtjes së të dhënave personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen gjatë aktivitetit të institucionit tuaj. Afatet duhet të parashikohen në përputhje me parimin e parashikuar në nenin 5/1/“d” të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale...“*të dhënat duhet të mbahen për sa kohë ekziston qëllimi*”. Gjithashtu në këtë dispozitë duhet të evidentohet qëllimi i mbajtjes së të dhënave.

Të specifikohen në këtë p/akt, marrësit e të dhënave personale në rastet e përhapjes së të dhënave, baza ligjore që legjitimon përhapjen dhe masat e sigurisë gjatë dhe pas përhapjes.

Zbatimi i nenit 30 të projekt/Rregullores të realizohet nëpërmjet nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit dhe njëkohësisht në këtë nen të parashikohet ky standard si aneks bashkëngjitur. (referojuni faqes zyrtare www.idp.al për tu njohur me standardin e deklaratës së ruajtjes së konfidencialitetit).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
